



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP. Anr.59/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti-kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi-anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e Subjektit Politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK) me seli në Prizren, të parashtruar kundër Subjektit Politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 31.12.2025, merr këtë,

V E N D I M

I. Pranohen si të bazuara ankesat e parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK) me seli në Prizren, ZP.Anr.59/2025, dhe ZP.Anr.60/2025, të datës 29.12.2025

II. Subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët në ditën e votimit, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 500.00 euro (pesëqind euro).

III. Detyrohet Subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Më datë 29.12.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat e subjektit politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK) me seli në Prizren, ZP.Anr.59/2025, dhe ZP.Anr.60/2025, nga të cilën pretendohet se më datë 28 dhjetor 2025, në ditën e votimit, kandidatë për deputet nga radhët e Subjektit Politik PREBK, Blerim Avdo dhe Gjyzel Shaljani kanë thyer heshtjen zgjedhore duke postuar në rrjetin e tyre social facebook, fotografi duke bërë thirrje për të dalur në votim dhe për të votuar Subjektin Politik PREBK përkatësisht numrin 133. Si provë në ankesa parashtruesi ka bashkangjitur fotografi.

Në përgjigje në ankesë të Subjektit Politik PREBK, theksojnë se pretendimet e Subjektit Politik LPRK, janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara në fakte dhe prova.

Më tej në përgjigje të ankesave ZP.Anr.59/2025, dhe ZP.Anr.60/2025, theksohet se z. Blerim Avdo dhe znj. Gjyzel Shljani, kandidatë për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 28 dhjetor 2025, nga Subjekti Politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës

PREBK, nuk kanë bërë thirrje votuesve për të votuar subjektin politik PREBK, por kanë bërë thirrje për dalje në votim komunitetit romë që të votoj me dinjitet, përgjegjësi për dhe rrugëtimin e tij në shoqëri. Thirrja për të dalë në për të votuar, konsiderojnë se nuk është shkelje, e as ndikim në ndonjë subjekt të caktuar politik dhe se në fotografën e bashkangjitur në ankese nga pala ankuese nuk figuron asnjë shenjë e subjektit politik, nga ana e z. Avod dhe nuk ka dëshmi apo prove se ka bërë thirrje në QV apo në VV ku ka votuar. Prandaj përmes kësaj përgjigje kërkojnë nga PZAP-ja që ta hedh si ta pa bazuar në prova, ankesën e subjekti politik LPRK.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZP.Anr.59/2025, dhe ZP.Anr.60/2025, të datës 29.12.2025, të paraqitura nga subjekti politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK) kundër Subjektit Politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me numrat e ankesave si më lartë dhe të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët ZP.A.nr.59/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën, përgjigjen në ankesë vëren se ankesat janë të bazuara

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik PREBK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LPRK, janë të bazuara dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet se *“1. Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.1 shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi të votuesit; 1.2. bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.”* Si dhe nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimit Financiar, ku përcaktohet se *“1. Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.5. shfrytëzimi i mediave lokale ose ndërkombëtare dhe rrjeteve sociale me qëllim të ndikimit tek votuesi.”*

Lidhur me pretendimet nga përgjigja në ankesë ku kundërshtohet pretendimi ankimor, se postimi i kandidatit se nga përmbajtja e fotografisë dhe nga përshkrimi i saj, nuk mund të interpretohet se ka pasur thirrje për votim të subjektit politik PREBK, por thirrje e përgjithshme për shfrytëzimin e të drejtës së votës për qytetarët, Paneli i konsideron si të pabazuara për faktin se postimet e fotografive në rrjetin social Facebook në ditën e zgjedhjeve, në të cilat shihet numri 133 i subjektit politik në fjalë dhe numri 9 i kandidatës së subjektit politik, është veprim që bie në kundërshtim me nenin 37, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli, konform nenit 13 paragrafi 7 të Rregullores Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin përcakton se *“Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme.”* Prandaj Paneli ndërmori hetim lidhur me pretendimet e përgjigjes në ankesë të subjektit politik PREBK dhe gjeti se e ankesa nga subjekti politik LPRK, është e bazuar, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në rrjetin social Facebook shihet se kandidati Blerim Avdo ka bërë publikime në rrjetin social Facebook në mbështetje të subjektit politik PREBK me datë 28 Dhjetor 2025 në ora 15:50 minuta dhe kandidatja Gjyzel Shaljani ka bërë

publikime në rrjet social Facebook në mbështetje të subjektit politik PREBK, konkretisht numrit rendor 9 të këtij subjekti me datë 28 Dhjetor 2025 në ora 15:04, minuta, kështu duke shkelur rregullat për heshtjen zgjedhore në ditën e zgjedhjeve.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesë janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se veprimi i përshkruar në ankesën e parashtruar është në kundërshtim me dispozitat e nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 i Ligjit NR.08/L-228 dhe nenit 8 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimit Financiar. Po ashtu, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë ditës së votimit, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesa nga parashtruesit e ankesave paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtat i pranoi si të bazuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.59/2025 më datën 31.12.2025

Kryesues i Panelit,
Hajriz Hoti



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.